



DRTK SHKODËR
SEKTORI I AAAMTK-së

MIRATOHET


Për K. K. T. K. M

Sekretari

Ark. Klesta QIRICI

RELACION TEKNIK

***PROJEKT RESTAURIM DHE KONSOLIDIMI
"KISHA TRIKONSHE NË KALANË DRISHT", SHKODËR***



JANAR 2024

PËRMBAJTJA :

<i>Hyrje</i>	<i>3</i>
<i>Vendodhja</i>	<i>4</i>
<i>Përshkrimi arkitektonik.....</i>	<i>5</i>
<i>Problematika dhe ndërhyrje.....</i>	<i>9</i>
<i>Bibliografia.....</i>	<i>14</i>

Hyrje

Objekt i këtij projekti restaurimi është pasuria kulturore Kisha Trikonshe në Kalanë e Drishtit, Shkodër.

Në çdo projekt restaurimi dhe konsolidimi faza e parë e projektit është ajo e konsultimit të materialeve arkivore, hulumtimi i materialeve historike që disponon DRTK Shkodër në lidhje me këtë objekt si dhe studimi i materialeve të vëna në dispozicion nga IKTk Tiranë. Kjo fazë është e rëndësishme për të ndërtuar kronologjinë historike të pasurisë kulturore, dokumentimin e ndërhyrjeve restauruese të mëparshme, si edhe evidentimin e ndryshimeve që kanë ndodhur me kalimin e kohës. Puna kërkimore është pasuar nga rilevimi fotografik i objektit që do të restaurohet, rilevimi gjeometrik për të hartuar pastaj dhe rilevimin arkitektonik.

Rilevimi gjeometrik ndihmon në vizatimin e saktë të planimetrive, ndërsa rilevimi fotografik vjen në ndihmë të dokumentimit të zonave ku do të fokusohen këto ndërhyrje.

Një rilevim arkitektonik i kujdesshëm dhe evidentim sa më i detajuar i degradimeve do ndihmojë për hartimin e një projekti restaurimi sa më të plotë dhe efikas.

Materiali është i organizuar si më poshtë: pjesa që i përket studimit historik të banesës, përshkrimi arkitektonik i saj, për të vazhduar me problematikat, ndërhyrjet, specifikimet e ndërhyrjeve restauruese.

Vendodhja

Kisha trikonshe në Drisht të Shkodrës, për të cilën së pari na flet Ippen, ngrihet e veçuar në një fshat shkëmbor ne brendësi të kalasë, pranë mureve rrrethues të anës lindore. Drishti ndodhet 10km në veri-lindje të Shkodrës, në luginën e lumit Kir.



Fig 1. Harta e Shqipërise, evidentim i Qarkut Shkodër



Fig 2. Ortofoto, evidentim i kishës

Përshkrimi arkitektonik

Kisha Trikonshe në Kalanë Drisht është pasuri kulturore me status monument kulture e kategorisë së parë shpallur nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, me vendim Nr. 786/1 datë 05.11.1984.

Ajo paraqet një kapelle, muret e së cilës ruhen me një lartësi 1,5 – 2 m. Muratura e saj është e ndërtuar me gurë gëlqerore të papunuar, të vendosur në rreshta me prirje horizontaliteti, lidhur me llaç gëlqereje me rërë të imët, me fuga të holla në anën e jashtme. Në brendësi mbushja e mureve është me gurë të thyer, të vegjël. Muret janë ngritur drejtpërsëdrejti mbi tabanin shkëmbor. Kisha paraqet një mjedis drejtkëndësh në plan, më të gjatë në drejtimin lindje-perëndim, me tri absida të njejta në anën lindore, në atë veriore e jugore. Nga ato, vetëm absida lindore ka një dritare të ngushtë, të mbuluar dikur me hark, prej të cilit ruhen thembrat. Planimetria që kemi ndërtuar ne, ka disa ndryshime nga ajo e Ippenit që nuk paraqet murin perëndimor, të cilit sot i duket qartë forma dhe pse faqja e jashtme është rrënuar në pjesën e sipërme. Gjithashtu, përfundojnë në mënyrë të rregullt dhe këndet e fillimit të absidave që nuk janë të prera 45 grade, sic e jep Ippen. Në anën lindore kemi dy nike rrethore, të vendosura në qoshet e murit lindor dhe një kamare në murin jugor. Muret e të tria absidave nuk ruhen aq sa të shihen fillimet e konkave dhe, po për të njëjtën arsye, nuk mund të përcaktojmë mbulesën e dikurshme të kishës, nëse ishte me kupolë apo me çati druri. Jemi për këtë të fundit, duke u nisur nga mungesa e rrëzimeve të shumta në brendësi të kishës.

Përsa i përket kohës së ndërtimit të kishës, nisur nga planimetria dhe teknika e ndërtimit të mureve, mendojmë se ajo i takon shek. X-XI.




Foto 3. Prerje teknike e rrënojave të kishës. Burimi: Arkiva IKTK




Foto 4. Prerje dhe planimetria e kishës. Burimi: Arkiva IKTK

Problematika dhe ndërhyrje

Inspektimi i fundit në objekt është realizuar në janar 2024, nga speciliasitët e DRTK Shkodër, për të njohur nga afër problemikat që ky objekt kulti shfaq si dhe të dhën një panoramë të qartë të gjendjes aktuale.

Terrenit i pjerrët dhe shkëmbor përreth monumenti nuk lehtëson aksesin në këtë objekt, megjithatë inspektimi u realizua në pasën 90% të perimetrit. Struktura në gjendje rrënoje e kishës trikonëshe Drisht ruhet në gjendje të mirë, por ka nevoj për një ndërhyrje konsoliduese dhe mirëmbajtëse. Problematika fillestare është bimësia përreth objektit por edhe në lartësi të mureve. Gjithashtu në evidentimin në terren u konstatua degradimi i llaçit lidhës, gurë të cilët janë shkëputur nga struktura duke humbur kështu lidhjen me këtë strukturë por në disa raste edhe pozicionin fillestar.



Foto 5. Foto e fasadës kryesore




Foto 6,7. Fotot e ambienteve të jashtme të kishës





Foto 8,9. Fotot e ambjenteve të brendshme të kishës

Ky projekt parashikon konsolidim e objektit në total, duke bërë një ndërhyrje edhe në terretorin përreth.

1. Pastrim i rrënjëve dhe bimësisë përreth e në lartësi të muraturës

Në ambjentet e brendshme të kishës është identifikuar një rrënjë masive, e cila duhet të zhgulet mekanisht, pa dëmtuar strukturës e objektit. Rrënjët e tjera janë pozicionuar në ambjentet përreth mure të kishës, të cilat do të trajtohen me herbicid. Pastrimi i vegjetacionit të ulët do të realizohet mekanisht si në lartësinë e murit ashtu dhe në territorin përreth kishës.

2. Konsolidim i gurëve dhe kreut të muraturës.

Nisur nga problematika kryesisht në kreun e muraturës është parashikuar ndërhyrja për konsoliduese e kreut të muraturës.

3. Restaurim i murit dhe injektim

Ka disa grurë të cilat kanë humbur pozicionin e tyre fillestar apo për shkak të degradimit të llaçi janë shkëputur nga struktura totale. Në muraturë ndërhyrjet e propozuara janë restaurim i murit të gurit, injektimi, si dhe fugatimi




Foto 10. Fotot e ambjenteve të brendshme të kishës

Bibliografia

Arkivi Teknik i Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Tiranë

Punoi: Fatjon MLLOJA

Jozel RADOVANI

Sabrina KUÇI

Elson LAQJA